

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXII, nr. 6714  
E shtunë, 24 shtator 2022  
çmimi 0.40 €

## Garda Kombëtare e Iowa-s mbështet fuqishëm FSK-në



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

# KMDLNJ-ja KËRKON SHKARKIMIN E MINISTRES NAGAVCI

FAQE 4-5



Kanë dështuar të gjitha përpjekjet e bëra deri më tani për ndërprerjen e grevës në arsim e cila ka hyrë në javën e katërt. Edhe pas diskutimeve të shumta, të cilat janë bërë nga përfaqësues të institucioneve të Kosovës, nga përfaqësues të shoqërisë civile dhe të sindikatave, nuk ka asnjë datë të mundshme për

fillimin e mësimin. Si pasojë e grevës që ka nisur në sektorin e arsimit më 25 gusht, mbi 300 000 nxënës kanë mbetur pa mësim. Në lidhje me këtë situatë, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNJ) ka kërkuar dorëheqjen e ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci

## AKTUALE



SHBA-JA E ANALIZON ME 'SERIOZITET' KËRCËNIMIN BËRTHAMOR TË PUTINIT F. 2

OSMANI TAKON PRESIDENTIN E LETONISË, FLASIN PËR ANËTARËSIMIN E KOSOVËS NË KËSHILLIN E EVROPËS F. 3

KURTI VLERËSON LART LOBIMIN E EURODEPUTETIT MANDL PËR KOSOVËN F. 5

## EKONOMI



LANSOHET NË KOSOVË PROGRAMI I BERZH-it 'RINIA NË BIZNES' F. 8

AMBASADA ZVICERANE I DORËZON QEVERISË PLATFORMËN PËR PUNËSIMIN E TË RINJVE F. 8

## SPORT



KOSOVA KËRKON FITORE NDAJ IRLANDËS SË VERIUT F. 10



**LDK-ja: VENDIMET E JASHTËLIGJSHME TË MINISTRISË SË JASHTME PO E DËMTOJNË BUXHETIN E SHTETIT** F. 3



Behxhet Sh. SHALA - BAJGORA, me shokë

**FEHMI DHE XHEVË LLADROVCI, USHTARË BESNIKË TË ADEM DEMAÇIT DHE ADEM JASHARIT!** F. 6

**RENOVA**  
PUTZ  
Maqedoni  
Xhepçisht - Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
MITROVICË  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...

## Belgjika mbyll reaktorin bërthamor

ANTVERP, 23 SHTATOR - Belgjika më 23 shtator ka vazhduar planin për ta mbyllur një reaktor bërthamor pavarësisht prej thirrjeve që ta rimendojë këtë vendim për shkak të frikës se mund të ketë reduktime të rrymës gjatë këtij dimri.

E gjendur midis Francës, që varet nga energjia bërthamore dhe Gjermanisë të varur nga gazi dhe qymyri, Belgjika varet për gjysmën e kërkesës së saj për rrymë nga shtatë reaktorë të vjetruar bërthamorë që operohen nga Engie, kompani franceze.

Mbyllja e një prej katër reaktorëve në centralin Doel, në afërsi të Antverpit, është hapi i parë i vendimit të vitit 2003 që shteti të heqë dorë krejtësisht nga reaktorët bërthamorë deri në vitin 2025.

Në shkurt edhe një reaktor në centralin në Tihang, 50 kilometra larg kufirit me Gjermaninë, u mbyll, pasi për dekada me radhë aktivistët kanë kërkuar që Gjermania ta ndalojë prodhimin e energjisë përmes centraleve bërthamore.

Të të dy këta reaktorë më 2012 u gjet se kanë disa vrima në disa njësi, që detyroi autoritetet t'i hiqnin jashtë përdorimit. Gjatë këtij muaji është nxitur një



krizë politike pasi ministrja e Brendshme, Annelies Verlinden, kërkoi që të shtyhej mbyllja e reaktorëve, duke shkaktuar zemërim në Partinë e Gjelbër.

Të Gjelbrit e kishin vendosur si kusht heqjen dorë nga centralët bërthamorë kur iu bashkuan koalicionit qeverisës më 2020. Kërkesa e Verlinden u bë në

kontekstin e pushtimit rus të Ukrainës dhe ndërprerjeve të furnizimeve me energji për Evropën, që kanë rritur frikën se kontinenti do të përballet me

reduktime të energjisë në muajt e ardhshëm.

Për më tepër, Franca, po ashtu, ka rrezik të përballet me reduktime të rrymës, pasi gjysma e reaktorëve bërthamorë të vendit po i nënshtrohen mirëmbajtjes. "Me rrezikun e reduktimeve në Francë gjatë dimrit, me Gjermaninë që po largohet nga energjia bërthamore pavarësisht se po i mbarojnë furnizimet me gaz, ne e dimë se do të përballemi me sfida të mëdha", ka thënë ish-ministrja belge e Energjisë, Marie-Christine Marghem.

Partia e saj që, po ashtu, është pjesë e koalicionit qeverisës, ka kërkuar që vendi të heqë dorë nga energjia bërthamore. Megjithatë, operatorja shtetërore e energjisë në Belgjikë, Elia, tha se nuk pret që të ketë rrezik të furnizimeve. "Ne kemi kapacitete të mjaftueshme gjeneruese të energjisë për t'i mbuluar kërkesat", ka deklaruar një zëdhënës i Elias.

Qëkur Moska nisi pushtimin e Ukrainës më 24 shkurt, kriza energjetike në Evropë është përkeqësuar, teksa evropianët pritet që gjatë këtij dimri të paguajnë fatura më të shtrenjta për energji dhe disa vende kanë paralajmëruar se mund të ketë reduktime.

## ShBA-ja e analizon me 'seriozitet' kërcënimin bërthamor të Putinit

UASHINGTON, 23 SHTATOR - Shtetet e Bashkuara janë duke analizuar me "seriozitet" kërcënimet e presidentit rus Vladimir Putin për përdorim të armëve bërthamore për t'i mbrojtur rajonet në Ukrainë, ka thënë John Kirby, zëdhënës i Këshillit për Siguri Kombëtare në Shtëpinë e Bardhë. Megjithatë, ai ka thënë se Shtetet e Bashkuara nuk janë duke ndryshuar "pozicionin strategjik parandalues" dhe se Putini ka folur në mënyrë të papërgjegjshme.

Të mërkurën lideri rus ka paralajmëruar se shteti i tij do t'i përdorë të gjitha mjetet që ka në dispozicion për ta mbrojtur territorin e vet.

Kjo deklaratë ka ardhur teksa rajonet ukrainase, që kontrollohen pjesërisht nga forcat ushtarake ruse, kanë nisur të ashtuqajturat

referendume për t'iu bashkuar Rusisë.

Ukraina dhe aleatët e saj i kanë konsideruar këto votime si mashtruese dhe se përmes tyre Rusia po synon të fitojë legjitimitet. "Është precedent i rrezikshëm për Putinin që të përdorë këtë lloj retorike në kontekstin e një lufte që është duke e humbur brenda Ukrainës", ka thënë Kirby për transmetuesin britanik BBC.

Ai ka theksuar se duhet t'i trajtojnë këto rreziqe me seriozitet. "Ne kemi qenë duke kryer monitorime, aq sa kemi mundur, për t'i parë kapacitetet e tij bërthamore dhe mund të them se ne nuk shohim ndonjë indikacion që duhet ta ndryshojmë pozicionin tonë parandalues në këtë pikë".

Ai i ka konsideruar planet e presidentit të Rusisë për aneksim

të disa pjesëve të Ukrainës si "asgjë më shumë sesa manovrimet të Putinit që të tentojë sërish, përmes politikës dhe çështje zgjedhore, të fitojë atë që nuk po mundet përmes mjeteve ushtarake". "Mirëpo nuk do të funksionojë", ka thënë ai. "Askush nuk do t'i njohë ato. Ajo çfarë duhet të ndodhë është që Putini të largohet nga Ukraina. Ai duhet t'i japë fund kësaj lufte".

Presidenti Putin më 21 shtator ka shpallur mobilizim të pjesshëm të rezervistëve ushtarakë për luftën në Ukrainë.

Ministri rus i Mbrojtjes, Sergei Shoigu, ka thënë, në një intervistë televizive, se do të mobilizohen 300 000 rezervistë me përvojë përkatëse ushtarake.

Lufta në Ukrainë ka nisur më 24 shkurt.



## Japonia heq kufizimet për turistët e huaj

Tokio, 23 shtator - Japonia do t'i hapë dyert për turistët e vaksinuar pas më shumë se dy vjetëve me kufij të mbyllur për shkak të pandemisë së koronavirusit.

Prej 11 tetorit turistët do të mund të vizitojnë këtë shtet pa viza dhe nuk do të kenë nevojë

të angazhojnë agjenci udhëtimi.

Edhe kufizimi në numrin e turistëve që mund të hyjnë brenda shtetit në baza ditore është hequr, po ashtu.

Vizitorët ende do të duhet të tregojnë dëshmi se kanë marrë tri vaksina kundër

koronavirusit dhe një test negativ, ashtu që të hyjnë brenda shtetit.

Fluksi i udhëtarëve po mirëpritet nga qeveria dhe bizneset lokale, pasi valuta japoneze yen ka rënë në shkallën më të ulët në krahasim me dollarin amerikan.



## Osmani takon presidentin e Letonisë, flasin për anëtarësimin e Kosovës në Këshillin e Evropës



PRISHTINË, 23 SHTATOR - Presidentja e Kosovës, Vjosa Osmani, në vazhdim të takimeve në Nju-Jork, ka takuar homologun e saj të Letonisë, Egils Levits, me të cilin ka diskutuar për marrëdhëniet bilaterale, situatën aktuale në Kosovë, rajon e më gjerë dhe pasojat e zhvillimeve të fundit në luftën e Rusisë kundër Ukrainës.

Presidenca njofton se Osmani ka falënderuar presidentin Levits për mbështetjen që i ka

dhënë Kosovës, në veçanti në funksion të konsolidimit ndërkombëtar. “Në këtë drejtim, presidentja Osmani theksoi se anëtarësimi i Kosovës në Këshillin e Evropës është domosdoshmëri për mbrojtjen e të drejtave të qytetarëve të Kosovës pa dallim përkatësie”, thuhet në komunikatën për medie.

Në takim është diskutuar edhe për zhvillimet e fundit në luftën kundër Ukrainës dhe pasojat në raport me paqen dhe sigurinë

në kontinentin evropian. “Presidentja Osmani nënvizoi se Kosova është tërësisht në linjë me qëndrimet e ShBA-së, Britanisë së Madhe, NATO-s dhe BE-së kundër luftës së Rusisë kundër Ukrainës. Presidentja Osmani dhe homologu Levits diskutuan edhe për thellimin e raporteve bilaterale dhe ngritjes së tyre në nivel të partneritetit strategjik në fushën e mbrojtjes, sigurisë kibernetike dhe digjitalizimit”, është bërë me dije në komunikatën e Presidencës.

## LDK-ja: Vendimet e jashtëligjshme të Ministrisë së Jashtme po e dëmtojnë buxhetin e shtetit

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 23 shtator - Lidhja Demokratike e Kosovës ka mbajtur të premtën konferencë për medie lidhur me shkarkimet dhe emërimet e paligjshme për pjesëtarë të shërbimit diplomatik nga ana e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës (MPJD). Nënkrjetarja e LDK-së, Shqipe Mjekiçi, ka thënë se veprimet e kësaj ministrie, përveç që janë të kundërligjshme, kanë edhe implikime të mëdha financiare. Mjekiçi ka theksuar se shkeljet ligjore në këtë ministri janë shndërruar në normë, duke përmendur edhe mosharmonizimin e Rregullores 01/2022 me Ligjin për Shërbimin e Jashtëm.

Ajo ka shtuar se kjo rregullore ka

shuar në mënyrë arbitrare pozitën e drejtorit të përgjithshëm dhe kompetencat e përgjegjësitë i ka kaluar te sekretari i përgjithshëm. Mjekiçi përmendi edhe riaktivizimin e Serbisë kundër njohjeve dhe anëtarësimit të Kosovës në organizata ndërkombëtare dhe tha se në këtë kohë MPJD do të duhej të ishte më aktive se kurrë për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar. “Ka kaluar një vit e gjysmë prej fillimit të mandatit të qeverisë, asnjë njohje, asnjë anëtarësim në organizata ndërkombëtare e disa ambasada janë pa ambasadorë”, është shprehur Mjekiçi.

Nënkrjetarja e LDK-së i ka bërë thirrje qeverisë dhe MPJD-së që sa më parë të deklarohet dhe të japë përgjegjësi për veprimet që kanë rënduar shërbimin e jashtëm.



## Latifi takon eurodeputetin austriak: Mirënjohës Austrisë për ndihmën në shëndetësi

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

Prishtinë, 23 shtator - Ministri i Shëndetësisë, Rifat Latifi, ka takuar eurodeputetin austriak Lukas Mandl me të cilin ka biseduar për vazhdimin e bashkëpunimit në mes të dy vendeve në fushën e shëndetësisë. Ministri Latifi ka thënë se është shumë mirënjohës për angazhimin e Mandlit për lobimin e madh që ka bërë dhe po vazhdon të bëjë në institucionet e Bashkimit Evropian - Parlamentit, në mënyrë që të lehtësohet lëvizja e lirë e mjekëve nga Kosova dhe të qytetarëve të saj në përgjithësi në



shtetet e Bashkimit Evropian. Latifi ka thënë se sistemi ynë i kujdesit shëndetësor ka nevojë për

një partneritet solid me institucionet e vendeve evropiane, veçanërisht për

edukimin e avancuar të specialistëve tanë, dhe për mundësinë e financimit të kërimit, gjë që nuk ka ndodhur, me disa përjashtime individuale. “Përderisa përpqemi t’i rihvillojmë institucionet e avancuara të kujdesit shëndetësor përmes partneriteteve zhvillimore me ndihmën e miqve tanë si ju, ne kërkojmë një model dhe mundësi solide për ta përmirësuar cilësinë e shërbimeve të kujdesit shëndetësor bazuar në standardet e BE-së. Për më tepër, partneritetet e tilla me institucionet e BE-së, ne shumë besojmë se do të jenë të mundshme me ndihmën tuaj, për mundësinë e shfrytëzimit të

burimeve të financimit së bashku nga BE-ja dhe donatorë të tjerë të mëdhenj në mbarë botën”, ka theksuar ministri Latifi në takim me eurodeputetin austriak Mandl. Ndërsa eurodeputeti austriak Mandl ka shprehur shqetësimin e tij për mosliberalizimin e vizave për Kosovën. Ai ka theksuar se Kosova është vendi më i ri në Evropë dhe populli më i ri në Evropë, ku është mbyllur dhe nuk mund të lëvizë lirshëm. Ai u shpreh se Austria është e gatshme të ndihmojë shëndetësinë e Kosovës në të gjitha fushat që kërkohet interes me të vetmin qëllim - zhvillimin e sistemit shëndetësor.

## Berisha: Nuk rezulton asnjë lloj rivaliteti me Metën për drejtimin e opozitës

TIRANË, 23 SHTATOR - Kryetari i Partisë Demokratike (PD), Sali Berisha, ka thënë të premtën se mes tij dhe kreut të Partisë së Lirisë, Iliri Meta, nuk ka rivalitet për drejtimin e opozitës. Në një deklaratë për medie nga selia e PD-së, Berisha u shpreh se me Partinë e Lirisë do të

koordinohet për aksionin opozitar. “Nuk rezulton asnjë lloj rivaliteti. Takime bëhen, janë publike dhe jopublike. Jam i bindur që me Partinë e Lirisë do të ketë marrëdhënie shumë të mira dhe bashkërendim shumë të mirë. Sezoni që vjen, jemi në të

njëjtën valë, do t’i ndërmarrim të gjitha hapat e nevojshëm për suksesin e protestave tona”, ka thënë Berisha. Në lidhje me hapat e mëtejshëm të opozitës, Berisha nënvizoi se tashmë duhet punuar për protesta të qëndrueshme dhe greva.





## KMDLNj kërkon shkarkimin e ministres Nagavci

Kanë dështuar të gjitha përpjekjet e bëra deri më tani për ndërprerjen e grevës në arsim e cila ka hyrë në javën e katërt. Edhe pas diskutimeve të shumta, të cilat janë bërë nga përfaqësues të institucioneve të Kosovës, përfaqësues të shoqërisë civile dhe të sindikatave, nuk ka asnjë datë të mundshme për fillimin e mësimin. Si pasojë e grevës që ka nisur në sektorin e arsimit më 25 gusht, mbi 300 000 nxënës kanë mbetur pa mësim. Në lidhje me këtë situatë, Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar dorëheqjen e ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci

**EPOKA  
ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHINË, 23 SHTATOR** - Këshilli për Mbrojtjen e të Drejtave dhe Lirive të Njeriut (KMDLNj) ka kërkuar dorëheqjen e ministres së Arsimit, Arbërie Nagavci. "KMDLNj në të gjitha reagimet ka deklaruar se greva mbetet mundësi dhe veprim i fundit, vetëm pasi të shteren përpjekjet e tjera e që në këtë rast nuk janë shfrytëzuar nga adresa kryesore e përgjegjësisë institucionale, Qeverisë së Kosovës, përkatësisht Ministrisë për Arsim që, në vend të dialogut, ka ofruar muskuj përballë SBASHK-ut, prandaj KMDLNj ka kërkuar dhe kërkon shkarkimin e ministres Arbërie Nagavci", është thënë në reagimin e KMDLNj-së. Për shkak të grevës së organizuar nga SBASHK-u dhe mospërbushjes së kërkesave nga Qeveria e Kosovës, mbi 300 000 nxënës të të gjitha niveleve po

humbin orët e mësimin.

KMDLNj ka theksuar se pa asnjë dyshim se nxënësve në Kosovë me këtë grevë po u shkelen të drejtat e njeriut. "Qeveria e Kosovës është treguar kryeneçe duke bërë përpjekje jo ta zgjidhë problemin përmes një marrëveshjeje të negociuar me SBASHK-un, por ka sulmuar frontalisht SBASHK-un duke përdorur fjalor linçues, bullizues, kërcënues dhe shantazhues, sidomos ndaj kreut të sindikatës, Rrahman Jasharaj, sikur edhe duke i penalizuar përmes heqjes së pagës për kohën që kanë bërë grevë. Edhe kërcënimi i sindikalistëve grevistë me pasoja, heqja e pagës dhe përpjekja për thyerje të plotë me të drejtat e njeriut dhe standardet ndërkombëtare. Në anën tjetër, të drejtat e njeriut e humbin kuptimin kur me këtë veprim i shkelen të drejtat e të tjerëve, të nxënësve, në rastin konkret",

thuhet në reagimin e KMDLNj-së. Më 22 shtator një numër i konsiderueshëm i prindërve të cilët kanë fëmijë në institucionet parashkollore kanë realizuar një marsh për të bërë thirrje te palët për të arritur marrëveshjeje në mënyrë që të hapen institucionet parashkollore. KMDLNj ka vlerësuar se në situatën e krijuar duhet një zgjidhje e ndërmjetme. "Nëse nuk do të ketë marrëveshje, situata dhe qëllimi i grevës do të degradojë deri në masën që të krijohet një anarki. Në përballjen e dy të drejtave të padiskutueshme siç është kjo e SBASHK-ut dhe e nxënësve përparësi ka realizimi i të drejtës së nxënësve sepse prodhon pasoja shumë më të rënda andaj KMDLNj kërkon nga SBASHK-u të tregojë mirëkuptim duke hequr dorë nga kërkesat maksimale për faktin se mosmbajtja e mësimin po prodhon efekte zinxhirore në të

gjitha fushat, që nga entet parashkollore e deri tek arsimi universitar. KMDLNj thërret që procesi mësimor të fillojë menjëherë, në të kundërtën edhe SBASHK-u do të ketë përgjegjësi konkrete për shkelje të të drejtave të njeriut përmes bllokimit të procesit mësimor. Po shteren kufijtë e durimit për prindër dhe nxënës të cilët nuk duhet dhe nuk mund ta pësojnë për shkak të kryeneçësisë së qeverisë dhe SBASHK-ut", është thënë në reagimin e KMDLNj-së.

### Kuvendi nuk e miraton rezolutën për grevën në arsim

Kuvendi i Kosovës ka dështuar ta miratojë të premtën rezolutën e propozuar nga Partia Demokratike e Kosovës (PDK) për grevën në arsim. Rezoluta e partisë opozitare, PDK-së, ka paraparë që qeveria t'i nisë negociatat me Këshillin Grevist të Bashkimit të Sindikatave të Bashkuara të Kosovës (BSPK) brenda 48 orëve dhe të gjendet zgjidhje për dhënie fund të grevës. Kjo rezolutë ka paraparë, po ashtu, që në grupin punues për hartimin e Projektligjit për Paga, të përfshihen edhe përfaqësues të autorizuar të BSPK-së para se dokumenti të dalë për miratim para qeverisë.

Si pasojë e grevave që kanë nisur në sektorin e arsimit më 25 gusht, mbi 300 000 nxënës kanë mbetur pa mësim.

Deputetët nga opozita e kanë hedhur fajin te qeveria për mosgjetjen e një zgjidhjeje që do t'i jepte fund grevës, derisa deputetë të partisë në pushtet, Lëvizjes Vetëvendosje, kanë kritikuar Këshillin Grevist për mosfillim të mësimin.

Kryeministri i Kosovës, Albin Kurti dhe ministrja e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Arbërie Nagavci, kanë thënë se qeveria ka bërë hapa për zbutjen e krizës, duke prezantuar pakon për përballje me inflacionin.

### Propozime të reja për fillimin e procesit mësimor

Komisioni Parlamentar për Arsim të premtën ka zhvilluar një takim disaorësh me Këshillin Grevist të Sindikatave të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë. Deputetë të këtij komisioni kanë kërkuar ndërprerjen e grevës në arsim dhe kanë propozuar mënyra të zgjidhjes së problemit. Kryetari i këtij komisioni, Ardian Gola, i ka propozuar Këshillit Grevist që të nisë mësimin, por si formë sindikale për ta arritur përmbushjen e kërkesave të tyre të mos i vlerësojnë fëmijët me

# Universiteti "Kadri Zeka" dhe Akademia e Shkencave e Shqipërisë nënshkruajnë marrëveshje bashkëpunimi

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Rektori i Universitetit "Kadri Zeka", prof. dr. Bajram Kosumi, me bashkëpunëtorë, ka pritur në një takim zyrtar një delegacion nga Akademia e Shkencave e Shqipërisë kryesuar nga kryetari, akademik Skënder Gjinushi. Në këtë takim UKZ dhe AShSh kanë nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi.

Rektori i Universitetit "Kadri Zeka", prof. dr. Bajram Kosumi dhe kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, akademik Skënder Gjinushi, thanë se ndihen të kënaqur që

kanë lidhur një marrëveshje të përbashkët.

Kosumi e falënderoi AShSh-në, konkretisht kryetarin prof. dr. Skënder Gjinushi dhe stafin e tij, që vizituan UKZ-në dhe arritën një marrëveshje bashkëpunimi. "Jemi të kënaqur që të bashkëpunojmë ndërmjet vete që të arrijmë në hulumtime shumë më cilësore në vend dhe arenën ndërkombëtare.

Universiteti publik "Kadri Zeka" pret ndihmesën më të madhe nga akademia, sikurse edhe ne me forcat tona, me kapacitetet intelektuale dhe hulumtuese që i

kemi, do të jemi përherë bashkëpunues me Akademinë e Shkencave të Shqipërisë", ka thënë Kosumi.

Gjinushi ka pohuar se marrëveshja e sotme është një marrëveshje që parashikon bashkëpunimin në të gjitha fushat. "Universiteti mbulon pothuajse të gjitha fushat e dijes, ashtu si dhe Akademia për nga natyra e saj e ka misionin që të promovojë, zhvillojë, të nxisë kërkimin shkencor në fushat kryesore të dijes. Arsimit dhe shkencës sigurisht ecin së bashku, pra ndihmojnë dhe mbështesin

njëra-tjetrën, në këtë aspekt ka mundësi të shumta për të bashkëpunuar dhe pas arritjes së marrëveshjes do të shkojmë drejt konkretizimit të këtij bashkëpunimi", ka thënë kryetari i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Skënder Gjinushi. Sipas marrëveshjes në fjalë, të dyja institucionet do të bashkëpunojnë në të gjitha fushat e dijes, me përparësi shkencat me më shumë interes të përbashkët, për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore, konferencave, forumeve, simpoziumeve etj.

Në bazë të kësaj marrëveshjeje përfaqësues të UKZ-së, bazuar në kërkesat nga Akademia e Shkencave, do të përfshihen sipas fushave në komisionet e përhershme shkencore që funksionojnë pranë saj, në njësitë e reja të kërkimit shkencor ngritur pranë saj etj.

Delegacioni i AShSh-së, i shoqëruar nga menaxhmenti i UKZ-së, ka vizituar hapësirat e universitetit, bibliotekën universitare, sallat mësimore, laboratorët dhe kabinetet, për t'i parë nga afër ambientet ku zhvillohet procesi mësimor.



## Kurti e çmon shumë lobimin e eurodeputetit Mandl për Kosovën

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Kryeministri Albin Kurti ka pritur në takim deputetin e Parlamentit Evropian, njëherësh themelues dhe president i Shoqatës së Miqësisë Austri-Kosovë. Kryeministri Kurti shprehu mirënjohje për shtetin dhe popullin austriak për mbështetjen dhënë Kosovës për liri dhe pavarësi. Ai ritheksoi se Austria është një shtet mik i madh i Kosovës dhe partner i

rëndësishëm, duke veçuar programet dhe investimet e qëndrueshme të cilat mbështesin në vazhdimësi Republikën e Kosovës.

Gjatë takimit, kryeministri Kurti vlerësoi lart angazhimin dhe lobimin e eurodeputetit Mandl për Kosovën. Në veçanti theksoi përkushtimin e tij për ta çuar përpara agjendën e procesit të liberalizimit të vizave për qytetarët e Republikës së Kosovës.



→ nota. "Të merren notat si formë e presionit sindikal. Jam i bindur që efekti për fitimin e vëmendjes qeveritare në raport me kërkesat sindikale do të jetë relativisht i njëjtë si sot kur fëmijët janë të privuar nga e drejta për shkollim", ka thënë Gola.

Këshilli Grevist i Sindikatës së Bashkuar të Arsimit, Shkencës dhe Kulturës ka thënë se ky propozim i deputetit nga radhët e Lëvizjes Vetëvendosje, parti në pushtet, do të diskutohet në anëtarësi pas takimit.

Vjollca Shala nga SBASHK-u ka

thënë se qëllimi i tyre është arritja e një marrëveshjeje të përbashkët.

Shala gjatë fjalës së saj në Komisionin për Arsim ka thënë se kërkesat që i ka paraqitur BSPK-ja nuk janë vetëm për SBASHK-un, por për të gjithë të punësuarit në sektorin publik "Jemi sot këtu me qëllim të arritjes së një marrëveshjeje të përbashkët. Kërkesat që i ka paraqitur BSPK-ja nuk janë vetëm për SBASHK-un, por për të gjithë të punësuarit në sektorin publik", ka thënë Shala. Edhe Ymer Ymeri, sekretar i

SBASHK-ut, ka kërkuar nga ky komision që të koncentrohet për mënyrën se si të dalin nga greva. "Ju lutem të koncentrohemi në mënyrën që të dalim nga greva. Nëse kemi vullnet të dyanshëm, ju garantoj se sindikatat kanë vullnet që të dalin nga kjo situatë", ka thënë Ymeri.

Kreu i SBASHK-ut, Rrahman Jashraj, nuk ka marrë pjesë në raportimin e ministres Arbërie Nagavci dhe ministrit Hekuran Murati në Komisionin për Arsim. Grevën e kanë thyer vetëm disa shkolla dhe mësimdhënës që në

mënyrë individuale kanë nisur t'i mbajnë orët. Përveç mësimdhënësve, në grevë janë edhe punëtorët e administratës publike, si dhe shërbyesit civilë në institucione lokale dhe qendrore. Kërkesa kryesore e sindikatave të këtyre punëtorëve drejtuar Qeverisë së Kosovës është ndarja nga 100 eurove në muaj për punëtorët derisa të hyjë në fuqi Projektligji për Paga.

Qeveria e Kosovës thotë se Ligji për Paga, që parasheh rritjen e tyre, do të dalë në miratim së shpejti. Para disa javësh ajo ka

paraqitur një pako për përballje me inflacionin, në kuadër të së cilës punonjësit e sektorit publik përfitojnë nga 50 euro shtesë, nisur nga ky muaj.

Projektligji për Paga nga data 15 shtator deri më 6 tetor do të jetë pjesë e konsultimeve publike. Paga aktuale e mësimdhënësve në shkollat fillore të Kosovës është 470 euro, ndërsa me ligjin e ri pritet të arrijë në 620 euro. Mësimdhënësit e shkollave të mesme aktualisht marrin nga 530 euro dhe kjo shumë pritet të rritet në 696 euro.

# Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, ushtarë besnikë të Adem Demaçit dhe Adem Jasharit!



**Behxhet Sh. SHALA-BAJGORA, me shokë**

Filozofia e sakrificimit për liri: Ismet Sopi është ish-i burgosur politik dhe veprimtar i palëkundur i çështjes kombëtare. Gjatë hetimeve ishte torturuar brutalisht nga udbashët serbë dhe ata që flisnin shqip. Pas luftës, udbashët që flisnin shqip, u sistemuan si është më mirë në institucionet e Kosovës gjatë mandatit të të gjitha qeverive, kurse në qeverinë aktuale llogariten si vlerë e shtuar. Ismet Sopi mbeti i pasistemuar dhe pa përkujdesje të shoqërisë, me një gjendje jo të mirë shëndetësore. Shëndetin e la në burgjet e Kosovës dhe llogoret e ish-Jugosllavisë si i burgosur politik dhe si besnik, deri në fund i Frymëzuesit të shqiptarëve për pavarësi dhe bashkim kombëtar, Njeriut dhe Shqiptarit të Madh, Bacë Adem Demaçit. Si Ismet Sopi ka shumë ish-të burgosur politikë shqiptarë. Këtë hyrje të thjeshtë dhe simbolike e bëra për ta ndërlidhur shënimin e 24-vjetorit të rënies heroike të Fehmi dhe Xhevë Lladrovci bashkë me bashkëluftëtarë, gjithashtu ushtarë të bindur, deri në flijim, të Komandantit Politik të Shqiptarëve, të Papërsëritshmit Bacë Adem Demaçit dhe Komandantit Ushtarak të UÇK-së, Legjendarit Adem Jashari. Para dhe gjatë luftës në Kosovë Ismet Sopi ishte reporter i luftës dhe bashkëpunëtor i KMDLNJ-së. Në çastet e rënies heroike të Fehmi dhe Xhevë Lladrovci, me bashkëluftëtarë, Ismet Sopi, përmes telefonit më njoftoi për këtë duke më thënë të mos e bëjë menjëherë publik lajmin për të mos ndikuar në rënien e moralit të UÇK-së.

Menjëherë shkova te Baca Adem dhe i tregova se Zharava (ashtu e quante Baca), bashkë me Shoten, (Xheven) kanë rënë në altarin e lirisë. Fort u mërzit Baca Adem dhe sytë iu mbushen me lotë. Kohë më parë kur Fehmi Lladrovci e mbante pikën në Bellaqefc,

ishte vizituar nga Baca Adem i cili, duke e vlerësuar situatën drejtë e këshilloi Fehmiun që të tërhiqet shkaku se ishte e pamundur të mbrohej. Fehmiu ishte përgjigjur se nuk do të tërhiqej nga kjo pikë pa luftë aq më parë që të tjerët e kishin marrë atë pikë. I ndodhur në një situatë të përafërt të Shkëmbi i Gradines, Fehmi Lladrovci nuk pranojë të tërhiqet duke u martirizuar për Komb dhe Atdhe, bashkë me Xheven, Fatimen dhe martirët tjerë që nuk pranuan ta lënë Komandantin e tyre të vetëm. E dëshmuam se nuk kishin asnjë mëdyshje midis rënies me

nderë dhe dorëzimit të pandershëm. Gjatë qëndrimit në llogoret e ish - Jugosllavisë, Fehmi Lladrovci ishte hije përcjellëse e përhershme e Dritës për Liri dhe Bashkim Kombëtar, Bacë Adem Demaçit si dhe bashkëluftëtar i Legjendarit Adem Jashari. Asnjëherë dhe edhe në rast kur nuk është pajtuar me Bacen, nuk ka treguar mungesë respekti apo bindjeje, përkundrazi. Me shokë në Lepogllavë dhe Stara Gradishkë ishte jashtëzakonisht i afërt, i dashur dhe i ndjeshëm. Ishin një gjeneratë shembullore e të burgosurve politikë shqiptarë

në Kroaci: Baca Adem Demaçi, Dr. Haki Gashi, Dr. Hafir Shala, Nuhi Ahmeti, Avdullah Derguti, Basri Ibrahim, Binak Dinaj, Idriz Hyseni, Tahir Hani, Zeqir Emmini, Asllan Rashiti, Bejtullah Ademi, Zaim Beqiri, Ismet Sopi, Hysen Shurdhani, Pajazit Jashari, Naim Bujup Musteqja e Orllatit, Avdullah Rama, Rrahim Rama, Avdi Latifi, Zenel Baqaj, Riza Demaj, Bajram Bislimi, Fadil Bujupi, Fadil Dani, Besim Baraleci, Hilmi Muzaqi, Shpend Lushaj, Avdullah Rrustolli, Vehbiu nga Kumanova dhe Osmani nga Gjilani. Edhe unë, Behxhet Sh. SHALA, isha në të dhe ndjehesha shumë

krenar dhe i nderuar. Xhevë Lladrovcin e njihnim në bazë të letrave që i dërgonte, përmes Fehmiut edhe të gjithë neve. Ishin letra jashtëzakonisht të përmëshura, me një bukuresht të përkryer, kurajoze dhe, thuaja të papërsëritshme. Fat i keq që nuk janë botuar.

Fehmiu edhe gjatë qëndrimit në kampet e përqendrimit i thoshte fjalët që i tha gazetarit të BBC-së gjatë luftës se: "do të ishte shumë i lumtur të vdesë për lirinë e Kosovës...". Pas daljes nga burgu, banesën e tij në Zagreb, në Sheshin "Bana Jellaçiq", e shndëroi, bashkë me Xheven, në një zyre politike dhe ushtarake për të gjithë patriotët shqiptarë e që me fillimin e luftës e formoi një Brigadë që luftoi në mbrojtje të Kroacisë deri në çastin kur pjesa politike e shqiptarëve që e kundërshtonin luftën në Kosovë, e shpërndanë këtë formacion ushtarak. Fehmi Lladrovci, bashkë me Xheven kishin për qëllim që duke luftuar në Kroaci të pergatisnin luftëtarë për luftën në Kosovë e që e konsideronin si të pashmangshme. Në kohë sa ishte në Kosovë, Fehmi dhe Xhevë Lladrovcin e vizitonin më së shumti Baca Adem Demaçi, Ahmet Haxhiu, Nuhi Ahmeti, Avdullah Dërguti, Shashivar Makolli edhe unë. Po flasë për ne nga Prishtina kurse ata që ishin më afër sigurisht janë takuar më shpesh.

Fehmi dhe Xhevë Lladrovci u përjetësuan, jo me përmendoret në Drenas por me rënien e tyre heroike të Shkëmbi i Gradines. Ata e kryen detyren ndaj Kombit dhe Atdheut e që nuk mund të thuhet për ne, shokët e Fehmi dhe Xhevë Lladrovci. Ata shkuan me ndërgjegje të pastër sepse nuk e kishin për qëllim jetesën dhe mbijetesën personale por kishin qëllim fisnik dhe hyjnor, lirinë, pavarësinë dhe bashkimin kombëtar. Po të ishin gjallë, jo që nuk do të dëshpëroheshin me këtë gjendje por do ta luftonin këtë gjendje, nëse edhe do t'iu kushtonte me jetë. Shqiponjat fluturojnë lartë sepse atje është liria, pulat e ndukura palohen duke pritur një kokërr mëshirë. Fehmi dhe Xhevë Lladrovci ishin SHQIPONJA! Për aq kohë sa do të ekzistojë bota, njerëzimi dhe shqiptaria. Nuk mund të jetë ndryshe me ushtarët besnikë, deri në flijim të Bacë Adem Demaçit dhe Legjendarit Adem Jashari.



FOTO: Albert Sinani - PHOTOGRAPHER

## Vodhi 30 mijë euro, identifikohet e dyshuara dhe kthehet një pjesë e parave

Prizren, 23 shtator - Më 13 shtator në Stacionin Policor Prizren është raportuar për një vjedhje të rëndë. Viktima e rastit që gjendet me banim të përkohshëm jashtë shtetit ka raportuar

se persona të panjohur ia kanë vjedhur 30 000 (tridhjetë mijë) euro nga shtëpia e tij në Prizren. Pas një punë të mirë hetimore, hetuesit e Stacionit Policor Prizren kanë arritur ta

identifikojnë të dyshimtën dhe t'i gjejnë 14 000 (katërmëdhjetë mijë) euro fillimisht. "Policët hetues kanë vazhduar hetimet në ditët në vazhdim dhe me datë 22.09.2022 kanë arritur

t'i gjejnë edhe 9 400 euro (nëntë mijë e katërqind). Pas intervistimit të dyshimtës, me urdhër të prokurorit rasti shkon në procedurë të rregullt", ka njoftuar Policia e Kosovës.



## Komuna e Prizrenit dhe "Caritas"-i vazhdojnë bashkëpunimin

PRIZREN, 23 SHTATOR - Kryetari i komunës së Prizrenit, Shaqir Totaj, ka pritur të premten në takim Miriam Pikaar nga Caritas Europa dhe përfaqësuesit e Caritas Kosova, Alfred Pjetri, Pal Baftijaj e Orhan Miftari.

Komuna e Prizrenit ka njoftuar se, krahas bashkëpunimit të

mirë e të vazhdueshëm me "Caritas"-in, është diskutuar për zgjerimin e aktiviteteve, në veçanti për ruajtjen dhe trajtimin dinjitoz të qytetarëve në përgjithësi.

Me këtë rast është folur edhe për rritjen e bashkëpunimit përmes projekteve të përbashkëta që t'u dilet në ndihmë personave në

nevojë në gjithë territorin e komunës së Prizrenit.

Aktualisht komuna dhe "Caritas"-i operojnë përmes projekteve të arsimit dhe shëndetësisë por, në të ardhmen, do të shqyrtohen mundësitë për ngritjen e kapaciteteve edhe në kulturë dhe sport.



## Garda Kombëtare e Iowa-s mbështet fuqishëm FSK-në

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Në kuadër të bashkëpunimit të Gardës Kombëtare të Iowa-s dhe Forcës së Sigurisë së Kosovës, një ekip ushtarak nga Iowa po qëndron për vizitë në FSK, me qëllim të ndihmës për ngritjen e

kapaciteteve profesionale të pjesëtarëve të FSK-së. Lajmin e ka bërë me dije ministri i Mbrojtjes, Armend Mehaj.

Me këtë rast në kazermën "New Born" të Regjimentit të Parë të Këmbësorisë në Gjilan është

duke u realizuar punëtorja e përbashkët mes FSK-së dhe ekipit të Iowa-s me automjetet luftarake-taktike ASV. "Kjo punëtorja ku po trajnohen pjesëtarët e tri regjimenteve të këmbësorisë është e fokusuar në

sistemet e armëve, taktikat, teknikat dhe procedurat e avancuara të operimit me ASV, me ç'rast pjesëtarët e FSK-së po përfitojnë nga përvojat e instruktorëve ushtarakë amerikanë. Garda Kombëtare e

Iowa-s është duke ofruar mbështetje të pakursyer në trajnime dhe bashkëpunim të vazhdueshëm për ngritjen e kapaciteteve operacionale të Forcës së Sigurisë së Kosovës", ka shkruar Mehaj në "Facebook".



## Nagavci pranon disa ekzemplarë të pullës postare "Shtëpitë shkolla"

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Ushtruesja e detyrës e kryeshefes ekzekutive në Postën e Kosovës, Fakte Kadiu, së bashku me menaxheren për marrëdhënie ndërkombëtare, Argjira Grapci, u pritën në takim nga ministrja e Arsimit, e Shkencës, e Teknologjisë dhe e Inovacionit, Arbërie Nagavci.

Kjo e fundit ka pranuar disa ekzemplarë të pullës postare "Shtëpitë shkolla" e cila është emetuar nga Posta e Kosovës me rastin e shënimit të 30-vjetorit të themelimit të shtëpive shkolla. "Ky edicion i pullave postare përcjell mesazhin se arsimit është mbajtur gjallë edhe në kohë të vështira duke u bërë kështu bazamenti i shtetësisë së Kosovës. Përmes imazhit të pullës postare, nderohen të gjithë ata qytetarë që



ofruan shtëpitë e tyre për shkolla, mësimdhënësit, nxënësit e prindërit për kontributin dhe qëndresën e tyre për ta mbajtur gjallë arsimin shqip", ka thënë ministrja Nagavci.

Ushtruesja e detyrës e kryeshefes ekzekutive në Postën e Kosovës,

Fakte Kadiu, ka theksuar rolin dhe rëndësinë që ka pulla postare si një nga simbolet e shtetësisë, ndërsa ka përmendur nevojën e promovimit të këtyre pullave që janë edhe simbol i kujtesës kolektive dhe promovimit të Republikës së Kosovës.

## 25 spërkatëse të pemëve u shpërndahen fermerëve të Skenderajt

SKENDERAJ, 23 SHTATOR - "Edhe 25 spërkatëse të pemëve dhe tre atomizerë u shpërndanë sot për fermerët e komunës sonë nga programi ynë për bujqësinë, me një buxhet për 50 mijë eurosh më i lartë se vitin e kaluar, për mbështetje direkte dhe

subvencionim të bujqve", ka bërë me dije kryetari i Skenderajt, Fadil Nura. Ai ka thënë se falë programit të komunës që synon zhvillim të bujqësisë, brenda një jave regjistroheshin 60 fermerë që përfitojnë pajisje bujqësore.



## 15 raste të reja me Covid në 24 orët e fundit

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Ministria e Shëndetësisë ka njoftuar se në 24 orët e

fundit, pas 190 testimeve, janë konfirmuar 15 raste të reja me Covid. Në këtë

periudhë kohore janë shëruar 10 person, ndërkaq raste aktive janë 60. Në 24

orët e fundit vaksinën kundër Covidit e kanë marrë 22 qytetarë.



## Kërkohet themelimi i Agjencisë Kombëtare të Turizmit

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Është mbajtur tryeza me temën “Ripërtëritja e turizmit” e organizuar nga Oda e Hotelierisë dhe Turizmit të Kosovës (OHTK) në kuadër të shënimit të Ditës së Turizmit ku u kërkua që edhe Kosova ta ketë Agjencinë Kombëtare të Turizmit.

Kryetari i OHTK-së, Hysen Sogojeva, ka thënë se qëllimi i

kësaj dite është të sensibilizohet çështja e turizmit. “Pa Agjencinë Kombëtare nuk ka vlera të rritura të turizmit”, ka thënë ai. Sogojeva ka thënë se Qeveria e Kosovës duhet të jetë e vetëdijshme që ky sektor duhet të zhvillohet. Sipas tij, në asnjë qeveri deri tash nuk i kanë dhënë rendësi turizmit. “Fatkeqësisht, as në qeveritë e

mëparshme as në këtë nuk po zë vend turizmi. Kemi ngecje të turizmit. Pa zhvillimin e turizmit nuk ka zhvillim të mirëfillt të ekonomisë”, ka deklaruar Sogojeva.

Ambasadorja e Maqedonisë së Veriut, Shpresa Jusufi, ka thënë se është e rëndësishme t’i tregohet opinionit që në këtë lëmë duhet bërë më tepër.



## Lansohet në Kosovë programi i BERZh-it ‘Rinia në biznes’

**EPOKA E RE** Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Në selinë qendrore të BPB-së është mbajtur takim në mes të ushtruesit të kryeshefit ekzekutiv të këtij institucioni, Artan Sadiku dhe Mark Borwman, zëvendës-president i BERZh-it për politika dhe partneritete.

Përfaqësuesit e BPB-së dhe BERZh-it kanë nënshkruar marrëveshje për lansimin e programit “Rinia në biznes” për Ballkanin Perëndimor, që për herë të parë në Kosovë lansohet përmes bashkëpunimit të nënshkruar me Bankën për Biznes.

Kredia prej 4.5 milionë eurosh nga BERZh-i përmes BPB-së do t’u japë fonde kompanive lokale që janë në pronësi ose menaxhohen nga sipërmarrës të rinj, apo janë kompani të fazës së hershme ose mikro, si dhe biznese të gjeneratës së dytë.

Banka për Biznes tashmë ofron lloje të tjera të financave për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM) në bashkëpunim me BERZh-in. Krahas financave, BERZh-i do të ofrojë shërbime këshillimore në formën e konsulentëve, emësim dhe trajnim, të gjitha me synimin për ta nxitur ndërmarrësinë e të rinjve dhe përfshirjen financiare në rajon. “Kemi kënaqësinë që të punojmë edhe një herë me partnerin tonë të vjetër ‘Banka për biznes’, këtë herë duke përkrahur ndërmarrësit e rinj dinamikë të Kosovës. Kosova duhet të krijojë më shumë



mundësi në shtëpi për fuqinë e saj të re të arsimuar. Sigurimi i qasjes më të mirë në financa dhe këshillat për sipërmarrësit e rinj do të kontribuojnë në zhvillimin ekonomik dhe ruajtjen e talentit”, ka theksuar Mark Borëman, zëvendës-president i BERZh-it për Politika dhe Partneritete pas nënshkrimit me BPB-në.

Artan Sadiku, ushtrues i detyrës i kryeshefit ekzekutiv “Bankës për Biznes”, ndërkaq shtoi se BPB-ja është e privilegjuar që ka

arritur marrëveshje për ta paraqitur programin “Rinia në biznes”. “BPB-ja është e privilegjuar që ka arritur një marrëveshje ekskluziviteti me BERZh-in për ta paraqitur Programin ‘Rinia në Biznes’ në Kosovë. Partneriteti ynë afatgjatë me BERZh-in ka rezultuar në një projekt tjetër, i cili këtë herë synon rritjen e ndërmarrësisë në Kosovë, duke i përkrahur pronarët e rinj të ndërmarrjeve mikro dhe të vogla. Programi është në vijë

me strategjinë e BPB-së, posaçërisht me përkushtimin tonë për të ofruar shërbime financiare dhe jofinanciare për sektorin e NMVM-ve. Besojmë se qasja jonë e gjithëmbarshme ndaj këtij sektori - pra, ofrimi jo vetëm i financimit, por edhe trajnimit dhe shërbimeve të tjera jofinanciare - do të sigurojë marrëdhënie të gjatë dhe të besueshme me klientët tanë”, ka thënë Sadiku.

Qeveria e Suedisë po e përkrah programin me një grant prej 3.5

milione eurosh për t’i ndihmuar bankat partnere vendase që t’i rrisin kapacitetet e tyre dhe të zhvillojnë produkte të reja financiare për sipërmarrësit e rinj si dhe për t’i ndihmuar firmat e vogla të kualifikuara në forcimin e operacioneve të tyre dhe ngritjen e bizneseve të tyre në një nivel tjetër.

Të pranishëm në këtë takim ishin edhe përfaqësues të Ambasadës së Suedisë në Kosovë.

## Ambasada Zvicerane i dorëzon qeverisë platformën për punësimin e të rinjve

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Në kuadër të bashkëpunimit të suksesshëm në mes të Qeverisë së Kosovës dhe Qeverisë Zvicerane është zhvilluar platforma për punësimin e garantuar për të rinj. Kjo platformë është donacion i Agjencisë Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim dhe projektit EYE për Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve. Për këtë qëllim, ministri

Hekuran Murati priti në takim përfaqësuesin e Ambasadës Zvicerane, Christophe Favre dhe përfaqësuesit e projektit EYE, për ta parë bashkërisht prezantimin e platformës së punësimit.

Gjatë takimit ministri Murati ka theksuar se punësimi është prioritet kyç i qeverisë, e këtë po e dëshmojmë përmes politikave që në qendër kanë punësimin e qëndrueshëm për të gjitha kategoritë.


Në anën e tij, Christophe Favre shprehu entuziazëm për projektin në fjalë dhe konfirmoi edhe një herë mbështetjen e qeverisë zvicerane për nisma të tilla që synojnë zhvillimin ekonomik për ngritjen e mirëqenies sociale.

Platforma për skemën e punësimit të garantuar për të rinj do të lansohet së shpejti nga Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve.





# Kush ishte Juda Iskarioti, dishepulli që tradhëtoi Jezu Krishtin?



Juda Iskarioti është më i njohur për tradhtinë ndaj Jezu Krishtit, duke e shitur këtë të fundit tek kryepfritërinjtë, një akt që çoi më pas në arrestimin dhe kryqëzimin e Jezusit nga romakët. Sot emri i Judës është sinonim i tradhtarit. Por ndryshe nga Apostujt e tjerë, përveç tradhtisë së Jezusit, për Judën nuk dihen shumë gjëra.

Në fakt, Juda është i vetmi Apostull që nuk ka një histori se si e thirri Jezusi të bëhej ndjekësi i tij. Emri i tij nënkupton se ai ishte pjesë e Sicarii, një fraksion radikal hebre në atë kohë. Sicarii e mori emrin nga kamati e gjata që mbanin anëtarët e tij, të njohura si 'sicae'.

Ata ishin vrasës profesionistë që eliminonin shpesh simpatizantët e Perandorisë Romake, zakonisht gjatë tubimeve të ndryshme apo gjatë pelegrinazhit në Tempullin e Malit. Por disa njerëz besojnë se mbiemri i Judës, nuk nënkupton se ai ishte anëtar i organizatës radikale. Dhe se mbiemri i tij buron nga fjala latine 'sicarius', që do të thotë vrasës. Një interpretim tjetër i mbiemrit të Juda Iskariotit, është se ai ishte nga qyteti Keriotit në krahinën e Judesë. Nëse kjo ka qenë e vërtetë, atëherë Juda ishte i vetmin Apostull që nuk ishte nga Galilea. Ndërkohë nuk dihet shumë mbi origjinën e tij. Ai

përmendet si Juda, biri i Simonit, por se kush ishte Simon Iskarioti kjo nuk dihet. Megjithatë ajo që dihet, është se Juda ishte arkëtar i Jezusit dhe i Apostujve të tjerë, dhe se herë pas here vidhte nga çanta e përbashkët ku mbaheshin paratë.

Në një moment Judës iu dhanë 30 monedha argjendi, në këmbim të tregimit të vendndodhjes së Jezusit. Në Kopshtin e Getsemanisë, Juda e puthi Jezusin në faqe, për ta identifikuar atë tek autoritetet, gjë që çoi në arrestimin dhe kryqëzimin e mëvonshëm të tij në kryq. Pas vdekjes së Jezusit, sipas tregimit të Ungjillit, thuhet se Juda u ndje fajtor për veprimet e tij, ia ktheu priftërinjve monedhat e argjendit dhe vrau veten shkruan bota.al.

Se përse Juda Iskarioti e tradhtoi Jezusin, kjo debatohet ende sot. Disa studiues spekulojnë se Juda e tradhtoi Jezusin, pasi donte që ai të udhëhiqte një rebelim të madh kundër romakëve, dhe kjo përputhet me hipotezën se ai ishte pjesëtar i grupit Sicarii, të cilët njiheshin për urrejtjen e tyre ndaj Perandorisë Romake.

Të tjerë thonë se ishte thjesht lakmia, ajo që e nxiti Judën të tradhtonte Jezusin, siç pretendojnë edhe Apostujt Marku dhe Mateu në Bibël. Po ashtu, disa

studiues argumentojnë se Juda nuk veproi me vullnetin e tij të lirë. Sipas tyre, ishte Satanai ai që zotëroi trupin e tij dhe e detyroi ta tradhtonte Jezusin.

Në Dhjatën e Re, Apostulli Gjon 13:27 thotë: "Sapo Juda mori të hajë bukën në darkën e fundit, tek ai hyri Satani... Kështu Jezusi i tha: "Atë që kë ndërmend ta bësh, bëje shpejt!". Ky episod mbështet idenë se Juda nuk kishte kontroll mbi situatën ku ndodhej, dhe se ishte Satanai ai që e detyroi Judën të shiste Jezusin, duke përfunduar në kryqëzimin e tij.

Megjithatë, fe të ndryshme dhe sekte të vogla të Krishterimit e shohin Judën në një këndvështrim tjetër. Këtu hyjnë gnostikët dhe myslimanët. Kjo rrymë, e konsideruar si një herezi nga Krishterimi zyrtar, beson se bota materiale është e keqe, se ajo është e përkohshme dhe në fund degradon dhe vdes.

Gnostikët besojnë se ekziston një Zot transhendent që është jashtë sferës materiale, dhe ai është Zoti i vërtetë i shenjtë. Ndërkohë Zoti që adhuron populli hebre, i njohur si Jahveh, është perëndia e keqe e sferës materiale që kur e krijoi atë. Në këndvështrimin e Gnostikëve, duke qenë se Zoti, i njohur edhe si Ialdabaot, është krijuesi i botës materiale, dhe bota materiale

është e keqe, atëherë edhe Zoti është gjithashtu i keq.

Gnostikët besojnë se të gjithë njerëzit kanë pjesë të Zotit brenda tyre, dhe se vetëm përmes njohjes së Universit dhe luftës ndaj injorancës, mund ta njohësh plotësisht veten e vërtetë. Shumë nga këto ide burojnë nga filozofi i Greqisë së Lashtë, Platoni, i cili besonte se Zoti ishte gjëja më e mirë dhe më e lartë jashtë botës materiale. (Bota.al)

Po ashtu Gnostikët pretendojnë se filozofia e zbulimit të Zotit brenda njeriut, erdhi direkt nga Jezusi, nëpërmjet mesazheve të Apostujve, të cilat supozohej se iu përcollën peshkopëve të tyre. Gnostikët kishin pikëpamjet e tyre mbi Juda Iskariotin. Madje shkruan një Ungjill të tërë për të, i zbuluar në vitin 2006 nga "National Geographic".

Përkthimi i tij ka shkaktuar shumë debate, të cilat kanë çuar në interpretime të shumta të tekstit, që nuk pranohet si pjesë e Dhjatës së Re. Kur "National Geographic" publikoi për herë të parë Ungjillin e Judës në vitin 2006, ai pretendoi se Juda nuk ishte në fakt vërtetë tradhtari i Jezu Krishtit, por miku i tij më i mirë.

Po ashtu u pretendua se Jezusi donte të çlirohej nga forma e tij fizike, ndaj i kërkuan Judës të

bënte atë që bëri. Por me kalimin e kohës, studiues të tjerë e kanë përkthyer librin, dhe janë korrigjuar disa gabime të vna re në përkthimin e parë.

Në vend se të jetë miku më i mirë i Jezusit, Juda është mishërimi njerëzor i Ialdabaotit, i njohur gjithashtu si Demoni i 13-të. Pasi në teologjinë gnostike Ialdabaot, ai banon në Dimensionin e 13-të. Atje Jezusi pretendon se Apostujt e tjerë janë priftërinj injorantë, që po i mësojnë të krishterët të betohen për besnikëri ndaj Ialdabaotit të lig, dhe se Jezusi në fund sakrifikohet për këtë demon. Kjo besohet se është një mënyrë për të shpjeguar mospërputhjen në lidhje me sakrificën e Jezusit për mëkatet tona, përmes fatit të pakontrollueshëm të Judës, pasi Satanai e kontrolloi Judën, gjë që e ktheu atë në një vrasës dhe tradhtar. Ndërkohë në teologjinë islamike, Juda Iskarioti nuk shihet aspak si tradhtar.

Madje cilësohet si një mbrojtës i Jezu Krishtit. Në Islam, Jezusi është një profet i nderuar që besohet se ka lindur nga një mrekulli. Myslimanët besojnë se Zoti bëri që Virgjëresha Mari të ngjizte Jezusin pa baba, dhe se Jezusi bëri gjëra të mrekullueshme në jetën e tij.

| grunge.com – bota.al

**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT  
PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



**QENDRA SPORTIVE  
'BUJOËSIA'**  
TEL: 045/82 82 82

## Kosova kërkon fitore ndaj Irlandës së Veriut

“Dardanët” përballen me Irlandën e Veriut në Ligën e Kombeve dhe synojnë që të marrin maksimumin e pikëve nga kjo përballje, e cila është e parafundit në këtë kompeticion. Ndeshjen e fundit të përzgjedhurit e Alain Giresse e zhvillojnë më 27 shtator kundër Qipros në Prishtinë

**EPOKA ERE** Veton ZYMBERI

**PRISHTINË, 23 GUSHT** - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll sonte (e shtunë) përballet me Irlandën e Veriut në kuadër të Ligës së Kombeve. “Dardanët” e kanë fituar ndeshjen e parë të zhvilluar në stadiumin “Fadil Vokrri” me rezultat 3-1 dhe janë optimistë se mund të dalin fitues edhe në këtë ndeshje. Ekspedita e Kosovës ka mbërritur të premtën pasdite në Belfast ku edhe ka zhvilluar stërvitjen e fundit për këtë ndeshje. “Ne do të rreshtohemi në mënyrën më të mirë të mundshme. Por, pa dyshim që do të ketë ndryshime nga ndeshjet e kaluara sepse kemi mungesa në ekip”, ka thënë përzgjedhësi i Kosovës, Alain Giresse. Sulmuesi i skuadrës së Mallorcës, Vedat Muriqi është optimist për këtë sfidë. Ai ka thënë

se “dardanët” ashtu siç e fituan ndeshjen e parë duhet ta fitojnë edhe të dytën. “Sigurisht se synojmë fitore. Në Prishtinë kemi fituar dhe e dimë se çfarë na pret atje. Atje presim të ketë shumë shikues, ku të bashkuar do të na sulmojnë të gjithë, por edhe ne kemi kualitetet tona dhe ashtu siç e kemi fituar ndeshjen e parë, besoj se do ta fitojmë edhe të dytën”, ka thënë Muriqi. “Ne, në asnjë lojë nuk e kemi fituar me rezultat bindës apo me posedim të topit dhe gjuajte, por kemi luftuar dhe kemi fituar me shpirt luftarak. Edhe irlandezo-veriorët janë me mentalitet si ne të Kosovës dhe besoj se do të bëhet një lojë e fortë, por ne me armën tonë kryesore që e kemi shpirtin luftarak do të shkojmë atje dhe ta japim maksimumin”, ka shtuar Muriqi. Ndeshja mes Kosovës dhe Irlandës së Veriut do të zhvillohet në orën 18:00.



## Numri një i basketbollit në botë, Andreas Zagklis, viziton Kosovën

Prishtinë, 23 shtator - Për herë të parë Kosovën do ta vizitojë sekretari gjeneral i FIBA Botës apo numri një i basketbollit në botë, Andreas Zagklis. Ai do ta vizitojë Kosovën më 6-7 tetor, ku do të jetë i pranishëm në finalen e Superkupës Mbarëkombëtare, më 6 tetor në Mitrovicë, si dhe do të takohet me krerët e Federatës së Basketbollit të Kosovës (FBK), por edhe me krerët e shtetit të Kosovës.

Zagklis është një mbështetës i madh i basketbollit të Kosovës, duke përkrahur projekte të ndryshme, si dhe FBK-në, ku në shumë raste e ka lavdëruar punën që bën Federata. Kjo është vizita e parë e sekretarit



gjeneral të FIBA Botës. Më herët Demirel, president i FIBA Evropës dhe nënkryetar i FIBA-s.

Sekretarja e përgjithshme e FBK-së, Elvira Dushku, ka folur për rëndësinë që ka vizita e Zagklis në vendin tonë. “Vizita e sekretarit gjeneral të FIBA Botës, Andreas Zagklis, në Kosovë është e rëndësishme së veçantë, pasi kjo është hera e parë që numri një i basketbollit në botë e viziton Federatën e Basketbollit të Kosovës. Ardhja e tij konsiston me mbështetjen e fuqishme që Zagklis e ka për kryetarin Fetahu dhe bordin e FBK-së në punën tonë të përbashkët për zhvillimin e sportit tonë të zemrës, basketbollit”, ka thënë Dushku. “FIBA e ka dëshmuar mbështetjen e fuqishme për FBK-në nëpërmjet projekteve

më të rëndësishme si hartimi i planit strategjik të FBK-së 2021-2025, edukimi i trajnerëve, licencimi i klubeve, mbështetja e kadrove të FBK-së për edukim si administrator dhe menaxher të sportit, si dhe projekteve për zhvillim të gjeneratave të reja, në veçanti zhvillimit dhe masivizimit të basketbollit ndër vaxha. Ne jemi shumë të lumtur që z. Zagklis, krahas takimeve institucionale, do të jetë i pranishëm edhe në finale të Superkupës Mbarëkombëtare, ku do ta ketë rastin të jetë dëshmitar i një organizimi të nivelit të lartë organizativ nga FBK dhe KB Trepça”, ka shtuar Dushku.

## Zvicra ndalon Xhakën e Shaqirin të festojnë me ‘Shqiponjë’

**CYRIF, 23 SHTATOR** - Festimi me shqiponjë i Granit Xhakës dhe Xherdan Shaqirit në vitin 2018, kur Zvicra u përballë me Serbinë, shkaktoi jo pak reagim në medie, teksa nga serbët u quajt provokim ndaj tyre. Edhe në “Katar 2022” helvetët do të përballen me kombëtaren serbe teksa përsëri simboli i shqiponjës ka marrë vëmendje.

Drejtori i përfaqësueses së Zvicrës, Pierluigi Tami, ka kërkuar nga futbollistët shqiptarë të helvetikëve që të mos festojnë me shqiponjë në Botëror. “Botërori nuk përbëhet vetëm nga ndeshja me Serbinë, edhe nëse e dimë se sa e veçantë është kjo ndeshje, duke pasur parasysh atë që ndodhi në vitin 2018. Ne nuk duam të bëjmë të njëjtat gabime. Ne jemi këtu për

të luajtur futboll dhe asgjë tjetër. Ne nuk duam të dërgojmë asnjë mesazh politik apo fetar. Ne duam t'i përfaqësojmë vlerat tona. Njëra prej tyre është respekti. Ne tregojmë respekt për opinionet e tjera. Për mua do të ishte gabim nëse do të provokonim dikë me një gjest, pavarësisht lojës”, ka thënë drejtori i përfaqësueses së Zvicrës, Tami.



## Mick Schumacher mund ta garojë edhe në sezonin tjetër me Haas

Oxnard, 23 shtator - E ardhmja e Mick Schumacherit mund të jetë sërish makina Haas, duke rinovuar edhe për një vit kontratën në Formula 1. Lajmi nuk është ende zyrtar, por Gunther Steiner, shefi i makinës amerikane, duket se është gati t'i japë edhe një shans pilotit të ri

gjerman. "Do të ulemi me Binotto në tavolinë dhe do të diskutojmë e vendosim. Sot për sot Mick ka 50 % shanse që të qëndrojë edhe një sezon me ne. Gjithsesi, ende asgjë nuk është vendosur. Nuk do të vendosim së shpejti, por as nuk duhet të vihemi nën presion", ka thënë Steiner. "Në

garën e fundit, në Monza, bëri një paraqitje të mirë, por në listën e pilotëve që po monitorojmë ka edhe persona të tjerë. Mund të përmend dy emra, si Nico Hulkenberg dhe Daniel Ricciardo. Ky i fundit duhet të vendosë se çfarë do të bëjë. Të shohim edhe pak kohë", ka shtuar Steiner.



## Kosova mposhti Malin e Zi, Krasniqi: Do t'i motivojmë vajzat për ndeshjet kualifikuese

PRISHTINË, 23 SHTATOR - Përfaqësuesja e Kosovës në grupmohën nën 17 vjeç në konkurrencën e vajzave ka shënuar fitore bindëse në ndeshjen e dytë miqësore kundër Malit të Zi me rezultat 3:0. Pas fitores në ndeshjen e parë me shifrat 4:2, kësaj radhe "Dardanet" e reja kanë mbizotëruar plotësisht ndaj bashkëmoshatareve të tyre nga Mali i Zi. Të tre golat të përgjedorur e Sanije Krasniqi i realizuan në pjesën e parë. Serinë e golave e hapi Shenarta Bela, me golin e realizuar në minutën e 11, për ta vazhduar më pas Sahare Berisha, me golin e minutës së 17. Golin e tretë dhe rezultatin përfundimtar e vendosi Albina Gegaj në minutën e 27. Në pjesën e dytë futbollistet e Kosovës e menaxhuan mirë lojën dhe nuk lejuan në asnjë moment t'u rrezikohet fitorja. Pas ndeshjes, përzgjedhësja Krasniqi u shpreh e kënaqur me atë çfarë treguan vajzat dardane në miqësoren e dytë. "Ndihe mirë në përgjithësi, por më shumë më pëlqen fakti se pas analizës së ndeshjes së parë vajzat



janë munduar t'i zbatojnë detyrat dhe mendoj se ky rezultat pozitiv ka ardhur pikërisht nga puna e bërë gjatë këtyre ditëve. Meqenëse këto janë vajza të moshës së re jemi përpjekur që tek ato ta transmetojmë disiplinën në punë. Besoj se këto dy fitore do t'i motivojnë vajzat për ndeshjet kualifikuese", ka theksuar Sanije Krasniqi. Këto dy miqësore i kanë

shërbyer përzgjedhësja Krasniqi që ta shohë formën e lojtareve dhe ta përgatisë sa më mirë ekipin për ndeshjet kualifikuese që zhvillohen muajin e ardhshëm në Shqipëri e ku, krahas Kosovës dhe Shqipërisë në Grupin 2 të Ligës B, marrin pjesë edhe Maqedonia e Veriut dhe Moldavia. Ndeshjet janë paraparë të zhvillohen prej 18 deri më 24 tetor.

## Vazhdon lufta mes vëllezërve Pogba, Mathias: Paul është shoqëruar gjithmonë me kriminelë

PARIS, 23 SHTATOR - Paul Pogba dhe i vëllai i tij Mathias kanë nisur prej disa kohësh një luftë mes tyre e cila është kthyer tashmë në një çështje të njohur publike. Mesfushori i Juventusit akuzoi të vëllanë se ishte pjesë e një strukture mafioze e cila kishte për qëllim t'i zhvaste paratë e tij. Për një kohë të gjatë akuzat dhe kundërakuzat vazhdojnë, ndërsa së fundmi Mathias ngrë shqetësimin se familja e tij është në rrezik pasi Pogba shoqërohet me kriminelë. "Shumë njerëz do të shokohen dhe do të habiten nga ajo që po flas, por e vërteta është se Pogba është shoqëruar gjithnjë me kriminelë. Për këtë arsye familja ime dhe të dashurit e mi janë në rrezik. Këta njerëz Pogba i ka përdorur për të qenë i mbrojtur në rrugë, por edhe për punë të pista. Tashmë ka nisur një konflikt edhe me ta, i ka tradhtuar dhe ka lënë familjen në shënjestër e tyre. Disa



nga të afërmit tanë janë kërcënuar apo janë qëlluar për shkak të situatës që ka krijuar Pogba, kemi frikë t'u drejtohem autoriteteve. Pogba duhet të mbante jashtë

rrezikut mamanë tonë, por ai vetë ndihet i sigurt pasi rrethohet me roje", ka thënë Mathias që thëllon edhe më shumë plagët në familjen Pogba.

### SHKURT

#### Pensionohet Goran Pandev

Goran Pandev e ka mbyllur karrierën në moshën 39-vjeçare teksa përvoja e tij e fundit ishte me skuadrën e Parmës në Serinë B. Ish-sulmuesi maqedonas ka pasur një përvojë të gjatë në Itali me klubet elitare si Inter, Lazio dhe Napoli. "Kthej kokën pas dhe ende nuk më besohet fakti që do të tërhiqem nga futbolli. Ka qenë një rrugëtim i jashtëzakonshëm, kam përjetuar shumë emocione dhe dua t'i falënderoj të gjithë ata që më kanë shoqëruar në rrugëtimin tim. Falënderoj familjen time dhe gruan, gjithashtu edhe babanë tim që më lejoi ta ndiqja këtë rrugëtim. Falënderoj të gjithë trajnerët për besimin dhe për atë çka më kanë mësuar. Një përqafim për të gjithë tifozët, mbyllet një kapitull i bukur, por marr me vete emocione shumë të bukura. Jam i lumtur që i kemi ndarë së bashku", ka thënë Pandevi.

#### Curry, afër nënshkrimit të një kontrate miliardere me kompaninë "Under Armor"

Basketbollisti i Golden State Warriorsit, Stephen Curry, është pranë nënshkrimit të një kontrate miliardare me kompaninë "Under Armour". Palët kanë 10 vjet që bashkëpunojnë mes tyre, ndërkohë që kontrata aktuale skadon pas një viti (fundin e 2023-shit). Sipas "Forbes", kontrata aktuale e lidhur në vitin 2013 do të pësojë një ndryshim rrënjësor në pagesën e lojtarit, 4 herë kampion në NBA. Pritet që Curry të firmosë një kontratë të përjetshme me kompaninë e veshjeve dhe pajisjeve sportive, nga e cila do të arkëtojë një miliard dollarë. Në vitin 2013 Curry firmosi një kontratë 10-vjeçare me Under Armour, ku fillimisht arkëtonte 4 milionë dollarë në vit. Kjo kontratë skadon në vitin 2023 dhe ka një vlerë që shkon në 215 milionë dollarë. Ndërkohë që kontrata e re do të jetë miliardere.

#### Saka zgjedhet lojtari i vitit tek Anglia

Futbollisti i Arsenalit, Bukayo Saka, është zgjedhur lojtari i vitit të kombëtarja e Anglisë. Lajmin e ka dhënë faqja e "Tre Luanëve", përmes rrjetit social "Twitter". 20-vjeçari pati një sezon fantastik si në kombëtare ashtu edhe në nivel klubesh. Me londinezët ishte një nga lojtarët më të rëndësishëm, duke shënuar 11 gola dhe asistuar në shtatë të tilla në Premierë Ligë.

#### Hazard: Dua të luaj më shumë te Reali

Ylli i Belgjikës, Eden Hazard, i cili është i grumbulluar me kombëtaren e Belgjikës për ndeshjet e fundit të Ligës së Kombeve, ka folur edhe për situatën që ai po kalon te Real Madridi. Belgu, ndër të tjera, tha se nuk është i kënaqur me minutat që ka marrë, ndaj dëshiron të luajë edhe më shumë. "Është një situatë delikate pasi dua të luaj më shumë. Ndihe mirë te Real Madridi, por e di se çka mund të bëj kur luaj", ka thënë Hazardi.

## Mbappe: Kam shumë më tepër liri në kombëtare sesa në PSG

Ka shënuar, dhe kjo nuk është diçka e re, me Francën në ndeshjen që fitoi 2-0 ndaj Austrisë. Por Kylian Mbappe i bën njerëzit të flasin jo vetëm për paraqitjet e tij në fushë, por edhe për disa

deklarata që nxjerrin në pah një notë të mundshme të "stonuar". Mbappe ka shpjeguar se si me Francën ndihet më i lirshëm për t'i shprehur aftësitë e tij: "Unë luaj ndryshe mes klubit dhe

kombëtares. Këtu më kërkojnë gjëra të ndryshme nga ato që më kërkojnë në klubin tim". "Sigurisht që kam shumë më tepër liri në kombëtare sesa në Paris Saint-Germaina. Trajneri e di që ai ka një lojtar si Olivier

Giroud që luan edhe në mbrojtje dhe kjo bën që unë të shkoj në hapësirat që krijohen. Te PSG-ja është ndryshe", ka shtuar Mbappe, i cili ka folur edhe për formën e tij dhe gëzimin që ndien kur luan me

Francën. "Më pëlqen të jem në skuadër. Gjendja ime fizike? Shumë e mirë. Prioritet është ekipi. Shpresoj të luaj të dielën në ndeshjen kundër Danimarkës", ka pohuar Mbappe.



# Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punes
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë




[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS TAVERNA

Tel: +377 45 400 156 +386 49 848 553  
PRISHTINË



044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Fatvera Januzaj, shpall të pavlefshme certifikatën e pikëve të maturës të Gjimnazit Filologjik "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Luan Pal Gjunaj shpall të pavlefshme shpall të pavlefshme Diplomën e Kolegjit "Iliria" drejtimi Banka Financa dhe Kontabilitet me nr. 871/11.

- Hana Nuha shpall të pavlefshme dëftesat e shkollës së mesme të vitit I, II, III me nr: 1130 të vitit 2000, 1594 të vitit 2001 si dhe 2128 të vitit 2002 drejtimi Elektro Teknik "Naim Frashëri".

- Larta Krasniqi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. Njëmbëdhjetë të Gjimnazit "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Kolë Vokraj nga Novosella e Epërme kll Gjakovë shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Kushtrim Hoxha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hjadar Dushi" Gjakovë.

- Rema Fazli Osmani Fushë Kosovë shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Eqrem Çabej".

- D.P.T "Beni" shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së, me nr. Të biznesit 70488671.

- Jahë Jaha nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M.Teknike "Nexhmedin Nixha", Gjakovë.

- Diana Brovina shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Sami Frashëri".

- Saranda Preniqi shpall të pavlefshme dokumentet e shkollës së mesme "Eqrem Çabej" Prishtinë.

- Edonis Gashi shpall të pavlefshme dëftesën e kl. së dhjetë të shkollës së mesme profesional "Prek Jakova" Prishtinë.

- Dr. Qamile Morina shpall të pavlefshme Licencën e Punës të lëshuar nga Ministria e Shëndetësisë së Republikës së Kosovës me nr: KO-00549-01-01.

- Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

- Urgjentisht kërkoj një banesë me qira ne Prishtine. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

- Lëshoj lokalin më qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanet me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkona. Për info 044/332-640.

- Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

- Lëshoj banesën me qira ne lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.

- Lëshoj banesën me qira, e cila gjendet prapa AAK-së, me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e telefonit: 044-162-783.





## ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

### Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

